

THE NEED FOR CONTEMPORARY INTERPRETATION OF THE QURAN

Abdulxhemil Nesimi

Faculty of Islamic Studies, Skopje, Macedonia, abdulxhemil_nesimi@hotmail.com

Abstract: The Quran is the last divine message that sent the last messenger, Muhammed (a.s) to the Arabic literary language, to challenge the world in general or a special Arab era, who was a speaker and a good supporter of Arab eloquence.

From the moment of subtraction the Almighty Quran came down to the Prophet's language in accordance with the law of sending the messengers, as he sent down all the precepts in the prophet's tongue and to the measure addressed to the divine message: "We did not send to any of the messengers except in the language of his people, so that he may explain to them (in that language)" (Ibrahim: 4)

Outwardly, the Quran seems to be like all other ordinary books, but from the content and the meaning it resembles and can not resemble any other book in the world. Parallel to memorization, it has been written, listed, and materialized in the tools of time, through sculpting on stone slabs, bones, bark, etc., a condition which has led to the discovery of contemporary writing tools. Unlike the other ordinary books, the Quran, besides being written constantly, is also transmitted by another very important element, with that of memorization.

His writing was done chronologically in a period of 23 years. Contains 114 chapters with a total of 6236 verses. The verse of verses and chapters is not chronologically sorted, but is listed according to the order of the Prophet (pbuh), which was also done on the basis of the announcement that dt.th. the Messenger of God himself was the one who ordered the order.

The invitation of the Quran to mankind is always open and invincible and as such will remain the word of Allah Almighty, His perfect quality, the perfect and meticulous message, free from any controversy and contradiction. The authenticity of the Quran leaves no doubt as to purity, coherence, harmony and meaningful continuity, the authenticity and completeness of its text.

Keywords: Quran, prophetic practice, revelation, interpretation, modernity.

1. NEVOJA E KOMENTIT TË LIBRAVE TË SHENJTË

Kur'ani Famëlartë zë një vend të lartë në literaturën arabe dhe nuk mund të gjejsh libër në botë i cili mund të krahasohet për nga vlerat e tij. Me që kanë kaluar më se XV shekuj, ai ka qëndruar i pandryshuar në formën e tij të shkruar kurse gjuha e tij është po në të njëjtën shkallë me gjuhën e sotme. Edhe librat me vjetërsi sa gjysma e moshës së tij, nuk janë në standardin që kemi sot. Ai u shpalla në gjuhën arabe sepse vet i dërguari ishte arab, kjo është shumë e thjeshtë dhe ja ç'thuhet në Kur'an: "Ne e zbritëm atë Kur'anin arabisht, ashtu që ta kuptoni." (Jusuf : 2)

Arsyeja për komentimin e librave të shenjtë qëndron në ndërlikueshmërinë e situatave jetësore që u duhet dhënë përgjigje, të cilat drejtpërdrejt nuk janë dhënë në librin e shenjtë. Andaj, të gjithë librat e shpallur pa përjashtim, iu nënshtruan më vonë procesit të komentimit, gjë që ndodhi edhe me Kur'anin fisnik.

Arsye tjetër pa dyshim është gjuha e librave të shenjtë, e cila kohë pas kohe humbet nga të folurit popullor dhe mbetet ose gjuhë letrare ose gjuhë rituale fetare.

Myslimanët, gjeneratë pas gjenerate do të orvaten që ta interpretojnë fjalën e Zotit, duke u bazuar në Kur'an, në hadithet e të Dërguarit të Zotit dhe ixhtihadin që afruan komentatorët nëpër periudha të ndryshme.

Gjuha e Kur'anit, madje edhe pas XV shekujsh të ekzistimit të saj në tokë, ka mbetur gjuhë letrare brenda territoreve arabofolëse. Ajo njëkohësisht është edhe gjuhë e shenjtë, sepse adhurimi kryhet në gjuhën Kur'anore. Sa më tepër që largohemi nga ajo kohë, aq më tepër kemi nevojë për koment, kurse gjuha e tij mbetet e pa prekshme dhe u përgjigjet të gjitha sfidave të jetës, ndërsa elani për të sa më tepër vjen e shtohet.

Ftesa e Kur'anit drejtuar njerëzimit çdoherë është e hapur dhe e pamposhtur dhe si e tillë do të mbetet gjithmonë, fjala e All-llahut xh.sh, cilësia e përhershme e Tij, mesazhi i përkryer dhe i përpiktë, i çliruar nga çdo kundërthënie dhe kontradiktë. Autenticiteti i Kur'anit nuk le asnjë dyshim për sa i përket pastërtisë, koherencës, harmonisë dhe kontinuitetit kuptimor, origjinalitetit dhe tërësisë së tekstit të tij.

2. ZANAFILLA E KOMENTIT TË KUR'ANIT

Komenti i Kur'anit Famëlartë është proces i cili zanafillën e tij e ka që nga koha e Muhamedit (a.s) dhe vazhdon deri në ditët e sotit.

Me që Kur'ani Famëlartë është prijatarë nga i cili dalin të gjitha njohurit Islame, duke filluar që nga monoteizmi, adhurimi, normativa, etika, të drejtat civile, sociale, ekonomike, politike etj, megjithatë, roli i të

Dërguarit të Zotit nuk do të jetë i anashkualuar në këtë pikëpamje, përkundrazi, do të jetë tej mase i rëndësishëm. Mu për këtë arsye, komentet që do të vijnë nga praktika profetike, do të luaj rol kyç në kuptimin e fjalëve të All-llahut Fuqiplotë.

Në Kur'an thuhet: "Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kur'anin)" (En-Nahël : 44)

Duke u përqendruar në këtë pasazh Kur'anor, kuptimii shprehjes "që t'u shpjegosh njerëzve", mendojë se lanëson dy aspekte të fuqishme, dhe atë:

Së pari, publikimi i Kur'anit dhe mosfshehja e tij, që të mos u ngjasojë kumtesave të më parëshme të cilat u fshehën dhe u devijuan. Fjala e fundit e Zotit t'i përcillet botës mbarë ashtu si e ka zbritur All-llahu i Madhërishtëm në zemrën e të Dërguarit të Tij, duke mbetur si i tillë-origjinal sa të ekzistojë gjithësisht. Gjë të cilën do ta dëshmojnë shumë as'hab dhe shkencëtarë Islam. Ndër to edhe vet Aishja, bashkëshortja më me zë dhe me famë e Pejgamberit a.s e cila ka thënë: "Kushdo që ju thotë se Muhamedi (a.s) ka fshehur diç nga ajo për të cilën është urdhëruar ta shpallë, ai ka bërë shpifje të madhe ndaj All-llahut."

Së dyti, sqarimi i fjalës gjegjësisht ajetit për të cilën populli ka nevojë për sqarim, ku vend dhe rol të posaçëm do të luaj praktika profetike.

Për të qenë sa më objektiv, në vijim do të paraqesshembuj Kur'anorë të cilët nuk mund të kuptohen me kuptim të saktë përveçse me anë të Praktikës profetike.

Në ajetin 82 të kaptinës El En'am, i Plotfuqishmi thotë: "Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë (dhulm), atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë."

Shoqëruesit e të Dërguarit fjalën "besim të kotë – dhulm" e kuptuan sipas kuptimit të përgjithshëm i cili përfshin çdo lloj padrejtësie sado e vogël qoftë, andaj edhe ranë në dilemë për këtë ajet dhe thanë: "O i Dërguari i Allahut! E cili nga ne nuk e ka përzierë besimin e tij me padrejtësi?!" Pejgamberi (a.s)¹⁷⁰ tha: "Nuk është ashtu, por për qëllim ka shirkun (idhujtaria, vënia shok Allahut). A nuk e keni dëgjuar fjalën e Lukmanit: "Vërtet që shirku është padrejtësi e madhe?" (Lukman : 13)

Shprehja Hyjnore në ajetin 32 të kaptinës El A'raf: "Thuaj: "Kush e ka ndaluar veshjen e bukur me rrobat e dhuruara prej All-llahut, të cilat Ai i ka krijuar për robët e Tij, si dhe Tajibatet (ushqimet e pastra e të ligjshme për ju nga All-llahu) si mirësi për ju?" (El Araf : 32)

Tradita profetike sqaron se disa prej zbulimeve janë të ndaluara. Është përcjellë se Pejgamberi (a.s) doli një ditë tek sahabet e tij dhe në një dorë mbante mëndafsh dhe në tjetrën ar, dhe tha: "Këto dyja janë haram për meshkujt nga populli im dhe hallall për gratë e tyre".

Nga shembujt e më sipër na bëhet e qartë rëndësia e Traditës Profetike në kuptimin e fjalës së Zotit. Kur i rishikojmë shembujt e përmendur, bindemi plotësisht se nuk ka rrugë tjetër për kuptimin e Kur'anit me kuptim të saktë veçse të shoqëruar me Sunnetin e Pejgamberit (a.s).

3. KUR'ANI LIBËR UDHËZUES

Nëse i hedhim një vështrim historisë Islame, do të shihshim se Kur'ani ka pasur një ndikim mahnitës në udhëzimin dhe udhëheqjen e njerëzve.

Historianët besojnë në këtë të vërtetë të pamohueshme historike se para ardhjes së Islamit bota ishte e zhytur në devijim shkencor dhe moral. Mbi popujt e botës dhe në veçanti mbi arabët sundonte ligji i dhunës, agresionit dhe shtypjes. Vjedhja dhe konfiskimet ishin shumë të përhapura, kurse njerëzit ndiqnin besime të gabuara dhe metoda agresive. Kur ndriçoi drita e Islamit dhe në skenë doli libri jetëdhënës Hyjnor, nën hijen e mësimave të larta kur'anore, njerëzit, nga jeta e devijuar e injorancës u orientuan drejt mirësisë, humanizmit, shkencës dhe moralit. Megjithatë disa njerëz shkurtpamës përpiqen të shpërfillin rolin madhështor të Kur'anit në ndryshim e thellë të njerëzve, ndërgjegjet e pastra dhe të zgjuara pranojnë të vërtetën që bota i ka borxh Islamit dhe Kur'anit.

Një realitet të tillë të Kur'anit e ka kuptuar edhe islamologu, Profesor Ian Hairpe i cili thotë: "Esenca e studimeve dhe kërkimeve tona në Universitet ka aspekt sekular. Për këtë arsye, kur ndalemi dhe hulumtojmë mbi Kur'anin, ne atë e vështrojmë si një dokument ashtu si të gjithë dokumentet tjerë. Por, unë jam i mendimit se nuk mund të shpërfillim ndikimi i thellë i Kur'anit dhe forma e tij letrare mbi njerëzit. Nga ana tjetër, kur e shohim se si ky libër ka mbjellë shpirtin e miqësisë dhe bujarisë midis popujve të vjetër dhe çfarë roli ai luan sot në jetën e njerëzve, vetvetiu thellohem në mendime. Kur'ani është një libër i cili me fjalë dhe gjuhë të rrjedhshme ka krijuar një letërsi të fuqishme ndaj të cilës ne nuk mund të qëndrojmë indiferent."¹⁷¹

¹⁷⁰ El-Kurtubi, *El-Xhamië li Ahkam el Kur'an*, vëll.I, fq. 37.

¹⁷¹ Emame, Adnan Muhamed, *Et texhdid fil fikr el islamij*, Dar ibn el Xheuzi, 2008, fq 98.

Nga karakteristikat kryesore të Kur'anit famëlartë është se ai nuk i takon tipit statik, por është urtësi dinamike që provokon mendjen dhe gjallëron zemrën. Në këtë urtësi ka një dinamizëm të fortë e penetruar, një fuqi lëvizëse e cila pandërprerë e nxit njeriun të studiojë, hulumtojë, zbulojë gjithçka në këtë tokë dhe gjithësi, që të kuptojë sekretet e tyre dhe të nxjerrë thesarin e tyre.

Është urdhër nga Perëndia i Plotfuqishëm të reflektuarit mbi ajetet e Kur'anit, sepse ajo është e vlefshme për të gjithë kohët dhe vendet dhe do të mbetet i tillë deri në Ditën e Ringjalljes.

Asnjëri nuk e mohon se në Kur'an ka kuptime, fakte dhe sekrete që do të zbulohen në të ardhmen dhe se të njëjtat nuk kanë qenë të kuptueshme nga komentatorët në periudha të mëhershme, me kalimin e kohës nga bashkëkohësit ajo gjen shpjegim në Kur'an. Atëherë, a kemi ne nevojë për interpretime të reja dhe bashkëkohore që lidhin Kur'anin me realitetin aktual që ne të zbulojmë më shumë kuptime që nuk ishin të pranishëm më parë, për të cilat nuk gjenin përgjigje në interpretimet e vjetër?

Me një fjalë, dinamizmi depërtues i Kur'anit është madhështor dhe i pazezistueshëm. Ai pandërprerë na këshillon dhe na porosit për të mësuar çdo shkencë, duke analizuar dhe kuptuar fenomenet e ndryshme që na rrethojnë përqark, siç duket qartë nga ajeti në vijim:

“Ne do t’ua bëjmë atyre të mundshme që t’i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri sa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtet” (Fusilet : 53)- është ftesë e përhershme për një kuptim të rinovuar dhe modern të realiteteve të Kur'anit famëlartë. Megjithatë, risitë vijnë si rezultat i hulumtimit, reflektimit, përpjekjeve dhe angazhimit të mendjes. Duhet të kemi kujdes në shkronjën e parë në ajetin: (Senurihim) – “do t’u bëjmë të mundur”, ku shkronja “sin” jep kuptimin e kohës së ardhme.¹⁷²

Sa herë të lexohet Kur’ani, e ardhmja është e padefinuar nga gjenerata në gjeneratë, deri në Ditën e Kiametit. Kjo të jep vizion të qartë, se shenjat e All-llahut nuk kanë të mbaruar, ato do të zbulohen ndër gjenerata.

Kur’ani Famëlartë në vete përmban parime, principe, koncepte të përgjithshme, përpunimi teknik dhe zbatimi i të cilëve mbetet detyrë e njeriut. Sipas rrethanave momentale, nevojave, problemeve të jetës dhe mundësive të zhvillimit, do të bëhet edhe zbatimi i këtyre koncepteve në jetë.

Format e zbatimit praktik të parimeve Islame nuk guxojnë të jenë të përhershme, ato ndryshojnë varësisht nga mënyra e jetesës në vende dhe kohë të caktuara. Për këtë, institucioni i ixhtihadit ka për detyrë të harmonizojë dhe përputhë zbatimet e principeve islame me zhvillimin dhe nevojat shoqërore, duke kërkuar në çdo kohë formën më të përshtatshme të zbatimit. Mjerisht, shumë herët është lënë pas dore zbatimi praktik i parimeve Kur’anore dhe është kaluar në teorizime skolastike dhe përsiatje të shterpëta. Kështu është ngadalësuar zhvillimi i mëtejshëm krijues i mendimit Kur’anor. Mendimi Kur’anor, faktikisht, ka përjetuar vetëm një formë të përpunimit dhe vetëm si e tillë është zbatuar mëse një mijë vjet.¹⁷³

Ndërkaq, sot është e qartë se jeta nuk mund të mbahet as të zhvillohet vetëm sipas atyre shablloneve dhe masa myslimane ka pritur gjatë dhe mbetur në një vend. Ndaj, myslimanët, nëse dëshirojnë të vazhdojnë jetën si besimtarë të sinqertë dhe të zënë pozicionin që u takon në zhvillimin bashkëkohor, patjetër duhet t’i afrojnë masës myslimane përpunime dhe interpretime të reja bashkëkohore të mendimit Kur’anor. Kjo ka qenë edhe mbetet kërkesa kryesore për renesancën myslimane.

4. OBJEKTIVI I KOMENTATORVE BASHKËKOHORË

Nga komentatorët e kohës moderne kërkohet që të shikojnë rethanat nëpër të cilat kalojnë myslimanët, për të nxjerrë alternava nga brendia e Kur'anit dhe jo thjesht të interpretojnë Kur'anin pa përfillur nevojat e myslimanëve dhe kërkesat e tyre.

Nëse sot problem kryesor është terrorizmi dhe kultura e varësisë, vargjet e dijes dhe urtësisë intelektuale dhe polemikës në mënyrën më të mirë, atëherë prioritet duhet që të ketë interpretimi i ajeteve që kanë të bëjnë me këto çështje dhe jo ajetet që ngërthejnë normativa dhe dallimet gjuhësore. Nëse problemi ynë sot është dominimi kulturor, shtypja dhe tirania, hipokrizia, poshtërim dhe fyerja, duhet të kenë prioritet absolut ajetet që flasin mbi këto dukuri negative nga interpretimi i ajeteve të tjerë. Nëse problemi është në sferën ekonomike siç varfëria, uria, mjerimi, privimi dhe papunësia, ajetet e Kur'anit në parandalimin e qarkullimit të parave në mes të pasurve dhe lufta kundër kamatës dhe të drejtën e të varfërve në pasurinë e të pasurve (Zekati dhe lëmosha), barazisë sociale, kanë prioritet absolut në interpretim.

Ne duhet që ta lexojmë Kur'anin me kujdesë dhe të shohim zgjidhjen e problemeve tona në të dhe atë për të cilën nuk ka nevojë gjenerata jonë nuk duhet tepruar në interpretim, sepse e njëjta nuk do të kuptohej. Kuptimi nuk është vetëm se në bazë të kulturës dhe nevojës për çështje sociale dhe kriza e jetesës. Kështu ne gjejmë

¹⁷² Er-Razi, Fahrudin, “*MefatihulGajb*”, vëll. XIV, fq. 121.

¹⁷³ El-Gazali, Hamid, “*IhjaUlum ed-Din*”, vëll. I, fq. 258.

alternativën e zgjedhjeve të problemeve që na tangojnë në këtë kohë në Kur'an dhe i interpretojmë ajetet e tij për t'i përshtatur nevojat tona në përputhje me vargjet e tij. Atëherë Kur'ani do të bëhej libër i lexueshëm në jetën e përditshme: universitete, ministri, shkolla, tregje, në shtëpi, dhe çdo struktur të jetës.¹⁷⁴

Në lidhje me një interpretim të tillë Dr. Mahmud Muhanna, profesor i Tefsirit dhe prorektor i Universitetit të El-Az'harit, thotë:

“Zoti i plotëfuqishëm na urdhëron që të reflektojmë në ajetet e Kur'anit kurse ne kemi nevojë për të dhënë interpretime të reja që të zbulojmë shumë kuptime në të gjitha shkencat. Duhet të qëndrojmë në frontin e kuptimeve të veçanta të shkencave të ndryshme që theksohen në Kur'anin e Shenjtë sepse, ato kuptime që i kemi arritur nuk janë prfundimtarë, ngaqë ngërthejnë edhe kuptime të tjera tek të cilat nuk kemi arritur deri më sot. Për shembull, në bujqësi kemi gjetur se Profeti Jusuf, pagja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të, arriti të zgjidhë problemin ekonomik të Egjiptit, kur u rekomandoj bujqëve¹⁷⁵, siç e përshkruan këtë krizë Kur'ani fisnik: “Ai (Jusufi) tha: “Mbllini shtatë vjet vazhdimisht, e çka keni korrur lënie në kallinj, përveç një pakice nga e cila do të hani” (Jusuf : 47)

Në sferën e teknologjisë, ne gjejmë se Kur'ani është i përfshirë në kuptime të pa zbuluar në të kaluarën dhe ka ende çështje që nuk janë zbuluar deri më sot, dhe ne duhet të qëndrojmë me këto ajete kur flitet për çështjet ushtarake në Kur'an, industrinë, përpunim të hekurit, potencialin ushtarak siç është rasti me këmishat blindues të cilës i referohen fjalët e Zotit të Plotëfuqishëm, “Ne i patëm dhënë Davudit dhuratë të madhe nga ana jonë “O male dhe shpezë, lartësoni (me tesbih) së bashku me të”. Ne ia zbutëm atij edhe hekurin (si brum). Puno këmisha të plota (nga hekuri) dhe thurri me precizitet ato. Dhe bëni vepra të mira (o familja e Davudit), se Unë vëzhgoj atë që ju punoni” (Sebe, 10-11). Qëllimi i kuptimit të shkencës ushtarake në Kur'an çon në prani të etikës së lartë në mënyrë që të mos rrisë padrejtësinë e të padrejtit dhe gjenocidi ndaj njerëzimit.¹⁷⁶

Në fushën e embriologjisë, ne gjejmë se Kur'ani na solli kuptime që nuk janë zbuluar deri më sot, dhe e njëjta ka qenë arsye që një numër i mjekëve gjermanë të pranojnë Islamin, të cilët ishin të specializuar në embriologji kur arritën të njohin kuptimet që gjenden në fjalët e Zotit të Plotëfuqishëm, “Ne krijuam njeriun prej një ajke (lëngu), e një balte. Pastaj atë (ajkën-baltën) e bëmë (shëndërruam) pikë uji (farë) në një vend të sigurt. Më pas atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, edhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirtë). I lartë është All-llahu, më i miri krijues.” (El-Mu'minun : 12-14)

Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, ne gjejmë kuptime të përfshira në fjalët e Zotit të Plotëfuqishëm: “All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja, All-llahu i donë ata që mbajnë drejtësinë” (El-Mumtehine : 8)

E njëjta gjë ndodh edhe në sferën e praktikës profetike dhe shkencat e tij, sepse në Kur'anin e shenjtë ka çështje që janë globale kurse Sunneti profetik i përkufizon, dhe më pas duhet analizuar atë që është shkruar më parë, për të nxjerr një përfundim në atë që ai e sheh si kusht që të mos ketë paraprirë dikush më parë: në mjekësi, bujqësi, industri apo shkencat të tjera, sepse të gjithë shkencat gjenden në Kur'an, ngaqë korespondojnë me çdo kohë dhe vend dhe do të mbetet i vlefshëm deri në ditën e Ringjalljes.

Në të ka shumë kuptime që janë zbuluar në kohët e sodit dhe të njëjtat nuk u zbuluan nga komentatorët e kaluar, me kalimin e kohës bashkëkohësit arrijnë të kuptojnë se e njëjta gjenden në Kur'an për më shumë se katërmëdhjetë shekuj më parë. Kjo tregon se ne kemi nevojë për interpretim të ri dhe bashkëkohor të Kur'anit të Shenjtë që ndëlidhet me realitetin aktual për të zbuluar shumë kuptime që nuk ishin të pranishëm më parë dhe për të njëjtat nuk gjenë përgjigje në interpretimet e vjetra.

KONKLuzion

Mendimi Kur'anor është shumë i gjerë, universal dhe analizues, nga çdo aspekt i pashtershëm. Me bukurinë e të shprehurit, me thellësinë e mendimit në zbërthimin dhe shpjegimin e të gjitha çështjeve që ngërthen në vetë, paraqet vlerën mbinjerëzore dhe si i tillë për muslimanët ka qenë, është dhe do të mbetet mrekulli e pashtershme dhe fuqi nxitëse e zhvillimit të thellimit të mendimit kreativ në jetën e përditshme. I ngjason oqeanit, ku në faqet e tij shkencëtarët si zhytësit që kërkojnë margaritarë nga thellësia e detit, në Kur'an gjejnë urtësi, filozofinë kulminante dhe rregullat e përkryera të mënyrës së jetesës.

Komenti bashkëkohor lindi si nevojë në fund të shekulli e XIX. Dijetarët të cilët u morën me këtë zhanër të komentit mbrojtën tezën se Kur'ani është libër univerzal dhe se ai duhet të komentohet dhe t'i komentoj rrethanat kohore, duke prekur dhe sqaruar problemet dhe preokupimet aktuale të botës islame, respektivisht,

¹⁷⁴ Emin, Ahmed, “Zuamaul Islah fil asril hadith”, Darul Kuttat el Lubnanij, 1979, fq.114.

¹⁷⁵ Ali El-Muhafisha, “El-itixhahat el fikrije indel arab fi asrin-Nehda”, El Ehlije lin-neshër, Bejrut, 1980.

¹⁷⁶ Nadir ebu Fetah, Tefsir el asrij minel Kuran, jekshif el xhedid min esrarihi, Kajro, 2005.

ashtu siç thotë edhe vetë mufesiri Reshid Rida, kthimi i vëmendjes tek çështjet të cilat i preokupojnë muslimanët bashkëkohorë.

Në Kur'an ka shumë kuptime që janë zbuluar në kohët e sodit dhe të njëjtat nuk u zbuluan nga komentatorët e kaluar. Me kalimin e kohës bashkëkohësit arrijnë të kuptojnë se e njëjta gjenden në Kur'an për më shumë se XIV shekuj më parë. Kjo tregon se ne kemi nevojë për interpretim të ri dhe bashkëkohor të Kur'anit të Shenjtë që ndëlidhet me realitetin aktual për të zbuluar shumë kuptime që nuk ishin të pranishëm më parë dhe për të njëjtat nuk gjenë përgjigje në interpretimet e vjetra.

Ndaj mendimin se ne kemi nevojë për shpjegime dhe kuptime të reja të Kur'anit, por më tepër për shkencëtar që zbërthejnë ajetet Kur'anore dhe atë që gjendet në praktikën profetike të lidhet me gjendjen e tashme, që të arrijmë deri tek thesaret e kuptimeve dhe misteret e shkencës që zbulohen, ku të njëjtën e hasim në Kur'anin fisnik shekuj më parë. Mirëpo, këtë nuk e kanë arritur dot përveç atyre që bëjnë përpjekje dhe analizojnë tekstet hyjnore.

Sipas një versioni besnik nënkuptohet se Muhamedi (a.s) paralajmëroi nevojën që secila kohë ta lindë njeriun që format e vjetra të zbatimit të koncepcioneve Islame do t'i zëvendësonte me forma të reja më të përshtatshme dhe problemeve të reja do t'u siguronte zgjidhjen adekuate.

Konsideroj se më me rëndësi është të shohim mendimin Kur'anor sot, çka na premtan dhe çfarë kontributi do t'i ofrojë zhvillimit bashkëkohor.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Ali, El-Muhafisha, El-itixhahat el fikrije indel arab fi asrin-Nehda, El Ehlije lin-neshër, Bejrut, 1980.
- [2] Emame, Adnan Muhamed, Et texhdid fil fikr el islamij, Dar ibn el Xheuzi, 2008.
- [3] Emin, Ahmed, Zuamaul Islah fil asril hadith, Darul Kuttat el Lubnanij, 1979.
- [4] Gazali, Hamid, Ihja ulum ed-Din, Dar ed-dijan lit-turath, Kajro, 1986.
- [5] Kurtubi, El-Xhamië li Ahkam el Kur'an, Darul fikër, Bejrut, 1993.
- [6] Nadir abu Fetah, Tefsir el asrij minel Kuran, jekshif el xhedid min esrarihi, Kajro, 2005.
- [7] Razi, Fahrudin, Mefatihul Gajb, Dar el fikër, 1993, Bejrut.
- [8] Sujuti, El-Itkan fi ulumil Kur'an, Dar Ibn Kethir, Bejrut, 1996.
- [9] Hanefij, Sadrudin Ali bin Ali bin Muhamedbin Ebi el Izz, Sherhu el Akide et Tahavije, Rijad, 1418h